



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme (4-të) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 10.02.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rrustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Lulzim Rrustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragacina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar

30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Bekim Shabani, DP
7. Safete Amerllahu, DGJK
8. Shkelzen Hajdini, DSH
9. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
10. Flamur Sylejamni, DI
11. Elmaze Behluli, DA
12. Sead Aliu, DI
13. Rasim Hasani, DA
14. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile
15. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj të jeni mirë dhe të keni shëndet.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, 30 dhe në këtë mbledhje ju kemi thirr më kërkesë të 14 anëtarëve të kuvendit të komunës.

REND DITE

I

Kërkesë për seancë të jashtëzakonshme lidhur me gjendjen në QKMF pas zhvillimeve të fundit atje.

Pastaj, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj nga kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, iu kalua fjala anëtarëve të opozitës lidhur me thirrjen e kësaj seance.

Arsim Jashari, tha së pari në emër të grupit të asamblistëve, të PDK-së, shpreh ngushëllime familjes Gashi për humbjen e familjarit. E falënderoj drejtorin e shëndetësisë për prezencën në kuvend, duke qenë i njoftuar se po sa ka marrë mandatin. Ngjarja e cila ndodhi javën e kaluar, ku humbi jetën një qytetar është mjaftë shqetësuese për ne si shoqëri, por ma shumë do të duhet të ishte për institucionin përkatës dhe Ekzekutivin! Kjo seancë e jashtëzakonshme nuk është thirrë për të bërë politikë, por nga kërkesat dhe ankesat e shumta të qytetarëve të cilët me të drejtë janë të revoltuar dhe po ndjehen të pa sigurt për mos marrjen e trajtimit shëndetësor adekuat. Nuk dua të flas për rastin pasi që janë duke u marrë organet kompetente si policia dhe prokuroria. Ajo çka dua të flas është shqetësimi dhe preokupimi im se çfarë drejtimi po merr politika dhe ndikimi politik në Komunën tonë, ku "Qytetarët janë të revoltuar nga papërgjegjshmëria, keq menaxhimi dhe nepotizmi. Në QKMF në Lipjanit, është gjendje alarmante dhe shqetësuese në kryerjen e shërbimeve elementare për pacientë. Qytetarët kanë humbur besimin në këtë institucion shkak të keq menaxhimit. Duhet të merren masa urgjente duke filluar nga drejtori i QKMF-se.

Nëse keni fituar 50%, nuk ju japin të drejtë të politizoni çdo institucion duke përdorur çdo mekanizëm, për të krijuar frikë tek punëtorët. Qytetarët ju kanë votuar për të punuar dhe për të menaxhuar mirë. Shfrytëzimi i pozitës për interesa personale dhe partiak është jo i mirë.

Shkelzen Hajdini, së pari ju shprehi ngushëllime familjes Gashi, për humbjen e të dashurit të tyre, si shkak i infarktit. Po ashtu ndjej keqardhje për familjen si shkak se ky rast u politizua, për shkak të një video injektimi të një pacienti tjetër. Sot keni thirrë seancë të jashtëzakonshme me arsyetimin se pacienti ka ndërruar jetë si pasojë e mos dhënies së shërbimit mjekësor, e që po e shfrytëzon për poenë politike. Unë do të shtoj disa pyetje? Cili është qëllimi i thirrjes së kësaj seance, a është qëllimi të njolloset shëndetësia në Lipjan me lajme të rreme, apo tentohet të manipulohet opinioni me disa video, që nuk ka të bëjë me rastin e pacientit, por me një rast krejt tjetër. Apo ka për qëllim avancimin e shërbimeve mjekësore në komunën e Lipjanit. Nuk pretendoj që jemi perfekt, por nuk jemi në nivelin e

shërbimeve mjekësore në nivel vendi. Kemi nevojë për përmirësime në shëndetësi, por nuk është gjendja qysh ju po e pasqyroni përmes disa videove. Është dashtë me pritë të zbardhet rasti pastaj te merremi me të. Mos jeni ngutur te bëni konstatime për rastin pa dhënë organet e hetuesisë ndonjë informatë, ku janë bazuar konstatimet e juaja se pacienti nuk ka marr shërbime. A është montuar video ingjizimi tjetër me një rast krejt tjetër. A i besojini postimeve tuaja qe nuk kishte asnjë mjek në QKMF. A i besoni deklaratave te familjareve qe shërbimi ju ka dhënë në mënyrë të rregullt. A e keni lexuar postimin e mjekut qe gjithçka ka shkuar ne rregull,ju ka bërë EKG-ja. A ndjeheni përgjegjës për informatën e dhënë. Cili ka qenë qëllimi i shpërndarjes së kësaj video. Në bazë të librit të protokollit pacientit në fjalë ju ka bër EKG-ja me datë 05.02.2022. Prej 1 janarit te këtij viti janë bërë mbi 500 EKG në QKMF. Gjatë tërë vitit gjysme milion vizita bëhen në QKMF dhe si mund të zbehet puna e tyre. Ka nevojë për përmirësim të shërbimeve në QKMF, por nuk është krejt zi. Unë do të angazhohem me ter qenien time qe te ofrohem shërbime sa me te mira, po edhe te ketë menaxhim sa me te mire. Sipas raportit të QKMF-së, pacientit i është dhënë raporti,po ashtu sipas raporteve te QKMF-së dhe kamerave të sigurisë nuk ka pritë një ore pacienti, po ju ka dhënë shërbimi , brenda një kohe te shkurte,po edhe autoambulanca është kthyer shumë shpejtë.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës, tha se pari kur çështjet janë të ndjeshme ne nuk duhet të shkarkohemi emocionalisht e politikisht, e te lëndohet dikush. Unë i shprehi ngushëllime familjes, Gashi për humbjen e familjarit te tyre. Shikuar proceduralisht kjo seancë nuk ka ditë me u thirre, nuk plotëson asnjë kriter. Edhe pse numerikisht nuk i plotësoni kriteret ne kemi shprehe gatishmërinë te jemi këtu, të ballafaqohemi me ju dhe te ju tregojmë qe e keni gabim. Në njërën anë ne shkresën tuaj konstatoni qe pa ju dhënë ndihma ka vdes pacienti? Qe nuk është fare e vërtetë, ndërsa në anën tjetër thoni ktheje mjekun. Ju vet keni kërkuar me shkresën tuaj qe te largohet mjeku. Në bazë të raportit zyrtarë të policisë së shtetit,janë marrë deklaratat e anëtarëve te familjarit,po ashtu edhe deklarata e mjekut kujdestar i cili ka konstatuar se i është dhënë shërbimi pacientit në fjalë,ndërsa trupi i pajetë merret nga njësia e mjekësisë ligjore për obduksion. Ndërsa rasti hapet si rast i trupit të pa jetë. Mjeku deklaroi ne facebook te vet qe ju ka bërë, EKG-ja, po ashtu familjarët kanë deklaruar qe ju ka bo EKG-ja. Ajo qe na takon neve te

punojmë, deri tani asnjë doktorë nuk ka mbet pa u punësuar pasi qe është e nevojshme me pas sa ma shumë mjek. Në njërën anë i lëvdojmë, ne anën tjetër i kritikojmë mjekët. Çka po fitojnë qytetarët e Lipjanit me këto video, kështu nuk i ndihmohet shëndetësisë.

Gazmend Qerkini, së pari i shprehim ngushëllime familjes Gashi për humbjen e familjarit të tyre. Pastaj tha se jemi dëshmitarë qe shëndetësia në Kosovë, po përballet me sfidat me të renda te cilat janë përditshmëri e jona. Politika është arenë mes pozitës e opozitës, por e njëjta nuk guxon të përdoret për ta shantatzhuar opinionin publik me video e shkrime. Rasti i fundit në Lipjan me video e mashtrime, nuk duhet te tentohet te bëhet shtrembërimi i një të vërtete të faktuar. Organet përgjegjëse duhet te merren me rastin dhe e vërteta e faktuar dhe jo e trilluar te dalë në shesh .E them qe mos të mos përdoret për qëllime te ulëta politike. Pasi qe video ka ndodhur pasi qe pacienti ka marr trajtimin e duhur dhe nuk ka pas asnjë ankesë nga familjarët. Ku ju e keni fajësuar mjekun për mos kryerje te punës dhe tani i dilni kishe në mbrojtje mjekut ne fjalë, ju si subjekt i LVV-së duhet ti kërkonti falje publike dr Farukut për fyerje publike qe i keni bërë dhe të gjithë qytetarëve të komunës së Lipjanit për stresin e shkaktuar e ku me këtë po bëni qe te humbet besimi në shëndetësinë kosovare. Nëse nuk e dini se me çfarë raste punon emergjenca në Lipjan pyetni familjarët tuaja dhe ata ju tregojnë. Me këtë po mundoheni ta fitoni ndonjë votë por, me këtë nuk mund ta bëni. Unë besoj ne organet kompetente qe e vërteta do te dal ne shesh.

Arsim Jashari, tha me rastin janë duke u marr organet kompetente, asnjë anëtar i PDK-së nuk ka shpërnda video as nuk ka qar familjarë për të bërë video, na jena ardh me zbuluar çka ka ndodh aty. Na do të jemi opozitë konstruktive dhe atij qe është në të mirë të qytetarëve do ta përkrahim, ndërsa aso qe është në dëm të tyre do ta kundërshtojmë. Dhe mua me takon e drejta te flas sepse kam marr votat e qytetarëve dhe askush nuk mund te ma ndal fjalën.

Daut Azemi, unë nuk ja ndal fjalën askujt vetëm kërkoja nga ana juaj qe ta respektoni rregulloren e punës së kuvendit te flisni me rend, dhe mos të ndërhyjni.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, ju po thoni qe jemi ardh me konstatua të vërtetën,por unë po ju them qe as unë as ju nuk mund ta konstatoni të vërtetën,pasi qe ne nuk jemi kompetent të merremi me këtë çështje.

Alban Salihu,tha se ne i falënderojmë doktorët për kontributin e dhënë e në veçanti ne kohën e pandemisë. Videon nuk e kemi bërë ne për këtë janë të njoftuar edhe policia. Mjeku është shkarkuar nga drejtori i shëndetësisë,jo nga ana jonë. Drejtori i Shëndetësisë dhe Kryetari bënë një mori pyetjesh, për të cilat përgjigjet duhet t'i japin vetë. Bënë shumë akuza të rënda, por nuk na befasojnë. Kjo është metodë e tyre e njohur, mbroju duke sulmuar.E kemi thirrur sot këtë seancë për të përsëritur atë që vazhdimisht e kemi thënë se gjendja në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan është e rëndë. Kjo gjendje kulmoi me datën 5 shkurt me rastin e ngjarjes së dhimbshme të vdekjes së një qytetari, të cilit nuk i'u ofrua shërbimi mjekësor si pasojë e mungesës së stafit, përkatësisht mjekëve si dhe mosfunksionimit të pajisjeve vitale për raste të tilla. Ky nuk ishte rasti i vetëm kur qytetarët kthehen mbrapshtë me arsyetime të tilla të mosfunksionimit të pajisjeve. Ajo çfarë ka ndodhur atë ditë është e papranueshme. Rrjedhimisht kërkohen disa përgjigje dhe disa përgjegjësi. Si është e mundur që urgjenca të lihet pa asnjë mjekë? Si është e mundur që asnjë ambulantë mos të ndodhet aty? A e dini kaosin që ka mbretëruar paraditen e së shtunës në Urgjencë? Pastaj, pse është suspenduar mjeku i QKMF-së për punën në Urgjencë? Pse të suspendohet mjeku që pastaj edhe është linçuar vetëm pse ka deklaruar me të drejtë që EKG nuk funksionon? Për që EKG nuk ka funksionuar, është dëshmuar edhe nga qytetarë të cilëve atë ditë i është kërkuar që ky shërbim të kryhet diku në privat, për këtë ekzistojnë edhe fakte të publikuara tashmë. Veprimi i suspendimit të mjekut nga Drejtori i Shëndetësisë a është veprim në panik apo veprim si pasojë e mos raportimit të drejtë nga hierarkia e QKMF-së? Shëndetësia në Lipjan, për këtë ekzekutiv nuk ka qenë asnjëherë prioritet, sepse prioritet ka qenë vetëm ndriçimi, dhe asfalti. Mjetet e dedikuara për shëndetësi, janë shpenzuar për zhavor. Edhe kur janë investuar pak mjete në QKMF, janë investuar keq. Kjo duhet të ndalet, ndërsa ekzekutivi duhet të dalë nga kjo gjendje komoditeti, ndërsa keqmenaxhimi i QKMF-së nuk mund të tolerohet më tutje. Drejtori aktual duhet të marr përgjegjësinë, e qytetarëve duhet të ju sigurohen shërbime shëndetësore.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha,kush don me verifikuar mundet me shku ne Prishtinë dhe me pa qe e ka pas te kryme EKG personi ne fjalë, po ashtu edhe mjeku ka thane ashtu ne facebook, ju dilni prapë thoni ju ska bërë.Ajo qe po ju them qytetarëve une i falënderoj te gjithë mjeket, po ashtu mjeku do te jetë i suspenduar deri ne përfundimin e procesit te hetimeve nga organet e rendit. Pastaj do te shkoj në komision dicplinor dhe komsisoni ta verifikoj. Une ju them pavarësisht mendimeve politike qe kemi, kur jane qeshtjet makro ne te mire te publikut duhet te jemi bashke e jo te paragjykojmë . Dhe mos ti politizojmë çdo rast te ndodhë.

Bashkim Budakova, thase pari i shprehi ngushëllime familjes Gashi për humbjen e familjarit te tyre. E kemi thirr ketë seance te jashtëzakonshme pasi qe kemi konsideruar qe është gjendje e jashtëzakonshme,ku me datë 5 shkurt ka gjet vdekjen një pacient ne QKMF. Po ashtu është shkarkuar mjeku kujdestar, ku sipas meje e ka kryer detyrën ne mënyrën më të mirë të mundshme,konsideroj se shkarkimi i tij është i pa drejtë dhe duhet të kthehet ne vendin e punës. Nuk mund të shkarkohet një mjek qe e kryen detyrën me përgjegjësi dhe e tregon vetëm te vërtetën. Kërkoj qe te përmirësohen shërbimet në shëndetësi dhe mos të përsëriten raste të tilla,po ashtu mjekët te dalin në krah të mjekut të shkarkuar.

Nexhmedin Lekiqi, ne stafi mjekësor para dy jave në këtë sallë u shndërruam në luan të vërtetë ndërsa tani kritikohemi. Ne po mundohemi me pas një shëndetësi zvicerane me ekonomi kosovare. Shëndetësia ekonomia, judikatura shkojnë krah për krah me njëra tjetrën. Te na ka me pas mungesë të mjekëve, por ka me pas edhe video si ajo me herët ku mjeku ingjizohet në vendin e punës,siç ishte rasti me dr Farkukun. E kur dihet se për shkollimin e një mjeku duhet një kohë e gjatë.

Fitim Mëziu,tha se ne profesionistët e QKMF-së në Lipjan që jemi në shërbim të popullit për t'i ndihmuar ata kur ata kanë nevojë, me gjithë mundin e dijen që kemi.Të jesh dëshmitar në përmirësimin e gjendjes shëndetësore ose në mjekimin e një të sëmuri eshte dhurata më e çmuar për një profesionist shëndetësor. Andaj, ideali i çdo mjeku, pra edhe i imi, është të mundohem të jap pacientëve tretmanin më të duhur nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër të percjell diturinë

dhe përvojën tonë kolegëve të mi të ardhshëm. Unë sot kam shumë emocione, sepse para juve prezantoj një mori të padrejtësive, diskriminimeve që ndodhin në QKMF. Populli ka nevojë për mjek dhe Infermier, ka nevojë që t'i ofrojmë shërbime sa më cilësore, por ne profesionistët shëndetësor mbijetojmë nga një gjendje e tmerrshme e shëndetësisë së fragmentuar, të një organizimi që aspak nuk i ngjanë mjekësisë familjare. Sa të duam ne mund të bëjmë foto, reklamime për shërbimet shëndetësore, investime dhe të tjera, por gjendja është ndryshe. Ne, sot po flasim me gjuhën e argumentit për amullinë në QKMF, e që si rezultat po pësojnë pacientët tanë, por po pësojnë edhe profesionistët tanë nga gjuha e urrejtjes dhe baltosjes, edhe pse ata japin gjithëcka nga vetja për të sëmurit tanë. Ne, dje suspenduam një mjek në orarin e punës me një numër enorm të vizitave gjatë ofrimit të shërbimeve nga njera njësi në tjetrën, për shkak të papërgjegjësisë menaxheriale dhe mosorganizimit, dhe i njëjti edhe përkundër kësaj, ai vazhdoi punën deri në perfundim të orarit. Ne kemi mjekë dhe infermier të mrekullueshëm, këtë e kemi thënë edhe para disa javësh në këtë kuvend. Por çdo punëtori pa përjashtim, në një mënyrë ose tjetrën i mohohen të drejtat e dala edhe nga kontrata e punës dhe diskriminohet. Sa me pak politika të udhëheqë me KPSH, aq më i mirë do të jetë organizimi. Ne, mjekët tanë të rinj i dergojmë në vende rurale pa përvojën adekuate ose në pjesën e emergjencës, në kundërshtim me ligjin, pa trajnime adekuate profesionale. Për shkak të papërgjegjësisë së Komunes, ne, profesionistët tanë nuk i përkrahim dhe për këtë prap kemi dëshmi se pagat jubilarë, pagat e 13-ta, të cilat pastaj përmes përmbarusit privat bëhen pagesa. Mos harroni se kënaqësia e mjekut është e vogël, ndonjëherë e vogël edhe mirënjohja për të, por kjo nuk do ta pengoj mjekun, i cili bën thirrje në vetëvete për të ndihmuar të sëmurin.

Albiona Tasholli, tha se kjo senanë e thirrur sot a është thirrur për qellime politike apo është thirrur për qellime të tjera të cilat i dini vetëm ju. Të gjitha këto akuza të cilat po I thuni janë të pa vërteta. Nuk është etike që për qellime politike të përfitosh nga fatkeqësia e dikujt tjetër. Sipa informative që kemi, nga familja personi në fjalë e kishte marrë tretmanin mjekësor dhe i kishte bërë të gjitha egzaminimet e duhura. Po ashtu edhe mjeku tani i supsentuar tregon se të ndjerit ju ka bërë EKG-ja. Nërsa video e cila është bërë virale në rrjetet sociale, personi në foto nuk është i ndjerri. Suspendimi i mjekut ka ardhë si pasojë e mos informimit të drejtë. Në

mënyren se si ju jeni qasur nuk po i ndihmoni drejtoratit të shëndetësisë,por vetëm po tegoni mos mirnënjohje ndaj tyre sidomos në këtë kohë pandemie qe po qendrojnë në vi të frontit.

Daut Azemi, kryesues i kuedit tha ju kisha lut qe te mos nderhyni ta respektoni rregulloren e punes se kuvendit, ose ndryshe do te ndermar masat qe janë në bazë të rregullores së punës.Po ua tërhqei verejtjen të gjithëve te bisedojme me qetësi, pasi qe do t'ua jep fjalën të gjithëve vetëm kërkoj nga ana juaj te jeni te qetë.

Egzona Bytyqi,tha se ne jemi te zgjedhurit e qytarëve dhe duhet me dhënë përgjegjësi për fjalën e dhënë dhe ma e pakta qe mujna me bo me tregu respekt dhe me pas kujdes me gjuhen e cila po perdoret sot ketu.Të flasës nën petkun e profesionistit shëndetësor per këtë temë e cila është bërë oibjekt hulumtimi i prokurorisë dhe gjithë atyre organeve relavante.Une perms kesj foltore familjes qe ka humbur te dashurin i shprehi ngushllime.Në secilin institucion shendetesor ndodhin vdekjet , edhe pse mjeku mundon me bo te pamunduren qe me shpetu nje pacient dhe nese vie deri te vdkeja e tij eshte sikur me humb anatarin e familjes se tij. Por edhe nese gezon shendet pacienti per mjekun eshte shume e mire.Ne si mjek keto dite kemi qene ne top lajmet e te gjitha portalve me tituj nga me te ndryshmit qe janë linqu kunder doktorit me emër dhe mbiemër nga komuna e Lipjanit.Në këtë aspet është cenu integriteti i tij moral e professional dhe ne nje far forme është arrit qe atij doktorri me ja zbrit imazhin te cilin e ka. E ma e randa krejt ku po jetë ndërgjgja kolektive a keni menduar ndonjëherë se presion ja keni shkaktuar edhe dr edhe rrethit te familjarve te tij,por edhe neve komunitetit te mjekëve dhe kolegëve të tij te cilët e njohim dhe kemi punuar me të. Një gjë nuk e kam të qartë vendimi qe është marr me shkarku dr, une i kam lexuar kontratën e punës dhe ligjet ne fuqi, dhe aty shenohet disa veretje si ajo me goje me shkrim, ndersa këto nuk jane respektuar. Vetëm është suspenduar .Kam një pyetje per drejtoratin e shëndetësisë cila është arsyeja qe është suspenduar doktorri? Tjetra puna e EKG, është një aparture mundet edhe mos funksionu por rregullohet. Edhe nese nuk ka bo EKG-ja, per infartin, ne i kërkojmë edhe disa analiza specifdike , ose padnomonike qe janë për këtë sëmurshmëri dhe në këtë rast edhe dr e kish kërkuar një troponin një lloj protoine e cila bëhet kur kemi dëmtim te muskulit të zemrës. Une disa here e kam cek në

séance se ne QKMF sa i perket diagnostikes jemi keq. Une e njoh dr Farukun dhe ai ka qenë shume respektues dhe ka reskpetuar edhe etiken profesionale.

Shahadije Bikliqi Dragaçina,tha se kryetari e drejtori i Shëndetësisë dhe shefi i grupit të LDK-së prej fillimit të seancës u munduan që opozitës me ia hedh fajin për zhvillimet e fundit në shëndetësi duke thënë se ne po inskenojmë e në fakt vetë po inskenojnë duke u munduar ta mbulojnë vetën. Nuk është aspak e vërtetë nga ato që u tha se ne po bëjmë politikë. Ne thjeshtë seancën e kemi thirre me kërkua përgjegjësi nga drejtuesit e QKMF-se,nga shefi i emergjencës e jo kundër mjekëve siç u tha nga Drejtori e Kryetari. Nuk ka pas video shantazhuese, ka pasë vetëm dëshmi që kanë dhënë dëshmitarët se me të vërtetë atë ditë ka pas kaos në emergjencë dhe i ndjeri nuk ka marrë me kohë shërbim. Këtë nuk e ka thënë vetëm një dëshmitar, por disa edhe atë publikisht. Dhe ju cfarë keni bërë, e keni suspenduar mjekun që ishte kujdestar në ambulant e jo emergjencë. Deklaratat e pacientëve të pranishëm në ditën kritike treguan dëshmi të fortë për atë se cfarë kishte ndodhë në të vërtetë dhe kjo nuk mund të mohohet. Ky rast ka vë në pah gjendjen reale të shëndetësisë në QKMF dhe AMF-të e komunës sonë. Rasti ka treguar se ka keqmenaxhim nga ana e drejtorit të kësaj qendre,shefit të emergjencës dhe ka treguar se për krejt këto vite ky sektor nuk ishte prioritet për udhëheqësit e komunës sonë. Por çështja të cilën dëshirojë ta ngris ka të bëjë me suspendimin e mjekut. Ky veprim konsideroj se ishte i ngutshëm. pasi drejtori i Shëndetësisë nuk është marrë me përgjegjësit kryesorë, se pse nuk ka pasur ofrim të shërbimit në atë periudhë kohore, por është marrë me mjekun i cili u tregua human dhe kreu punën e tij për rastin konkret . Prandaj kërkoj përgjigje nga drejtori se a është kontaktuar edhe mjeku për të marrë edhe versionin e tij para se të merrej vendimi për suspendim? Dhe cilët ishin ata mjekë që ishin kujdestarë të shtunën, ditën kritike, na tregoni emrat e mjekëve?

Ganimete Qeriqi,tha se në seancën e kaluar drejtor me bere përshtypje ne fjalim dhe prita qe 17 shkurtin pe festojmë me dhurata e mirënjohjeje por ndodhi e kundërta me suspendime – e suspenduat doktorin qe ka kontrolluar 200 pacientë. Mendoni sa konsumohet njeri për tu bërë doktor. Edhe mos harroni Bota i ka hap dyert për mjekët tanë ,po fytyra jone ku po jete. Mjeku

ktheje ne pune ,kërkoni falje,jepjani dëmshtëpërblimin se e keni thy moralisht, Dihet qe puna e jone është e ndjeshme e me rreziqe...

Besiana Syla tha, duke shikuar rastin e fundit që i takon një natyre tejet të ndjeshme, kam disa kërkesa, kritika dhe alternativa për gjendjen e Shtëpisë së Shëndetit në qytetin tonë. Gjendja në QKMF në repartin e Stomatologjisë është e rëndë. Kjo si shkak i mos marrjes së përgjegjësisë në të kaluarën dhe si pasojë e mosfunksionimit të pajisjeve kryesore aktualisht, ku qytetarët kthehen mbrapshtë, herë duke u drejtuar të shkojnë në ordinanca private e herë për në QKUK në Prishtinë. Gjithashtu, ka probleme edhe me kushtet elementare si ai i papastërtisë. Për dy mandate qeverisje e keni lënë në këtë gjendje në repartin e stomatologjisë dhe repartet e tjera, duke u fokusuar në sektorë të tjerë. Nuk po them që duhet që sektorët e tjerë të lihen anash a në harresë, por parësor duhet të jetë sektori i shëndetësisë.

Sa i përket kësaj çështje të ndjeshme, e shoh të arsyeshme të ofroj disa alternativa, kërkoj që të merret përgjegjësi nga ana e drejtorit dhe po ashtu kërkoj nga Kryetari që së bashku, pozitë e opozitë të marrim hapa konkret për QKMF-në në qytetin tonë. Të hulumtohen të gjitha problemet me të cilat përballlet QKMF dhe në bazë të tyre të ofrohen shërbime cilësore e të nevojshme, të bëhet kërkesa urgjente për blerjen e pajisjeve të reja e që janë më se të nevojshme, të rishikohet orari i punës dhe nëse stafi mjekësor nuk po ia del të jetë efikas shkak i fluksit të madh të pacientëve, të rirregullohet orari apo të rritet edhe numri i stafit nëse është e nevojshme. Nëse nuk mundemi t'ia dalim si komunë, të ndërmarrin hapa të tjerë, duke kërkuar ndihmë nga niveli qendror dhe Ministria e Shëndetësisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani,tha se pari nuk duhet me i pengu askujt pse është thirr seancë e kuvendit,pasi qe është e drejtë ligjore. Ne si opozite e kemi konsiderua se duhet të bisedojmë rreth gjendjes se fundit qe ka ndodhur ne QKMF ku në të gjitha portalet është publikuar dhe është diskutuar. Ju keni mujt mos me thirre seancën hiç, por edhe ju jeni pajtuar me neve qe duhet te diskutohet për këtë çështje. Video e parë ka dal qe doktori nuk i ka ofruar shërbim pacientit te ndjerë. Ndërsa me vonë del qe nuk ka të bëjë video me të njëjtin pacient por me një pacient tjetër. Familja deklaroi qe ju ka dhënë shërbimi, ndërsa drejtori i drejtoratit të

shëndetësisë,përmes faqes zyrtare te komunës del se e ka suspenduar doktorin Faruk Gashi, për neglizhencë të punës. Njeri thotë ka punuar EKG-ja tjetri s'ka punuar , njeri ju ka dhënë shërbimi tjetri s'ju ka dhënë shërbimi ne jemi këtu për ta diskutuar këta. Ai doktor e ka dhënë maksimumin dhe ata qe kanë kërkuar te suspendohet doktori duhet me kërkuar falje. Unë bëj thirrje anuloje atë vendim për suspendim të doktorit,dhe ktheje në punë. Dhe lejoni organet e drejtësisë për me zbulua rastin.

Fadil Spahiu, tha se kam një pyetje se në çfarë baze është suspenduar mjeku? Gjendja në QKMF, QMF-të dhe AMF-të në Komunën tonë është e rëndë, duke filluar nga mungesa e stafit mjekësor, e që për këtë arsye disa AMF janë jashtë funksionit, siç është në fshatin Smallushë edhe pse objekti i plotëson të gjitha kushtet teknike, nuk funksionon sepse nuk ka staf mjekësor. Në QKMF, hapësira jo e mjaftueshme për shërbimin e pacientëve, edhe pse disa herë është bërë renovimi i hapësirave të objektit nuk është bërë zgjidhje për hapësirën e shërbimit me infuzione. Për të marrë infuzione pacientët në QKMF në shumicën e herave duhet të presin në radhë deri sa të lirohet hapësira, sepse janë vetëm dy dhoma me nga tre shtretër, që janë të pamjaftueshëm në proporcion me numrin e banorëve të Komunës sonë. Andaj i bëj thirrje ekzekutivit që para se të bëhet rishikimi i buxhetit të shqyrtohen këto kërkesa dhe të bëhet planifikimi buxhetor i nevojshëm dhe i arsyeshëm që qytetarëve t'iu ofrohen shërbime sa më cilësore.

Arsim Jashari tha, nuk duhet me i ofendua njerëzit ne seancë, sepse duhet me pas edukate familjare. Unë as nuk e ofendoj askënd dhe nuk dua askush te me ofendoj. Është e drejtë e jona me thirr seancë, dhe me diskutua për atë qe ka ndodhur në shëndetësi dhe nuk ju lejohet juve me na mohu te drejtën për me diskutua për këtë çështje. Dhe nuk mundeni me na pengu pse na kemi thirr seance te jashtëzakonshme , ju keni mujtë mos me ardh hiç ne seancë mos me bërë kuorumin.

Daut Azemi kryesues i kuvendnit, tha merrni me qetësi, diskutimet dhe faji ke i te gjithëve dhe mos me detyroni mua qe me shkuar strikt me rregullore,unë ua ep fjalën sa here

qe te doni por mos ndërhyjni te njeri tjetri pasi qe do te diskutojmë deri sa ju te mendoni qe janë shter diskutimet.

Ganimete Qeriqi, tha qe është bërë gabim për suspendimin e mjekut na krejt po e dimë, por gabimin mund ta përmirësoni duke e kthyer mjekun ne pune. Me EKG më së shumti punoj unë, ndodh qe nganjëherë ai aparat nuk bon për shkak te rrymës apo ndonjë problemi tjetër.

Lulzim Rrustemi, tha se pari i shpreh ngushëllime familjes Gashi për humbjen e familjarit te tyre, pastaj tha se na e kemi një sistem te mire te ndërtuar pozite dhe opozite dhe nuk ka nevojë për emocione dhe mos e merrni për keq kur opozita thirr mbledhje për te diskutuar për ndonjë çështje. Pse tani bëhet gjithë kjo zhurmë, pse fjalët kërkoni falje, ne jemi përfaqësues te qyqarëve dhe kemi te drejtë si opozitë të thërrasim mbledhje dhe të diskutojmë për situatën aktuale. Shkarkimi i doktorit ka qenë nga drejtorati përkatës dhe aty ka procedura për shkarkim. Dhe ka për gjithçka procedura dhe këtu ka obligim menaxhmenti me dhëne informata. Dhe nuk është përgjegjësi e opozitës kush bënë video ose jo. Ne baze te informacioneve qe i kemi ne po diskutojmë si përfaqësues te kuvendit. Organet kompetente janë ato te cilat do te merën me këtë çështje. Ekzekutivi nuk duhet te bazohet ne baze te faqeve te facebook, por ne argumente dhe fakte. Kërkoj qe te ketë një fryme te mirë të bashkëpunimit në mes të pozitës dhe opozitës. Duhet te merret një vendimmarrje meritore duhet te priten vendimet e organeve te hetuesisë. Dhe kjo informatë është e mirë dhe me te po njoftohen edhe qytetarët

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se askush se ka mohuar te drejtën e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme, dhe nuk tha askush qe nuk keni te drejtë me thirr seancë se keni te drejt prapë nesër me thire është e drejt e juaja.

Albiona Tasholli, tha se unë gjatë fjalimit tim nuk ju drejtova askujt dhe nuk e di pse po i merrni personale. Gjatë fjalimit tim në foltore, tentuat të më pengonit, ndërsa kur ju mbajtët fjalimin tuaj unë nuk i pengova askujt. Dhe ne bazë të kushtetutës së Kosovës garantohet e

drejta e shprehjes, pa te penguar askush dhe askush nuk keni te drejtë te me pengoni kur unë flas.

Daut Azemi kryesues i kuvendnit tha ju kisha lut qe te mbani qetësinë dhe mos te hyni në diskutime personale por te respektoni rregulloren e punës.

Alban Salihu, tha neve po na akuzon ekzekutivi se e keni shkarkua mjekun, mjekun e keni shkarku ju dhe videon nuk e kemi bërë ne për këtë është në dijeni edhe policia, dhe policia e ka këtë informatë. Na për krejt çka kemi dhënë deklarata jemi te gatshëm me dhënë përgjegjësi. Kam pyetje direkt pse është suspenduar mjeku dhe sa mjek kanë qenë atë ditë në emergjencë.

Shkelzen Hajdini tha se mjeku nuk është shkarkuar, është suspenduar dhe vendimin për suspendim e kam marr unë për shkak te rastit te ndjeshëm dhe unë e barti përgjegjësinë. Në urgjencë atë ditë ka qenë një doktor, doktori tjetër ka qenë në pushim pasi qe është liruar nga shefi tina për shkak të pandemisë dhe është dashtë këtë me i sistemuar . A ka pas te drejt shefi i urgjencës me pas vetëm një mjek aty ose jo do ta shohim nder kohë. Unë është dashtë me marr vendimin për suspendim për shkak te rastit te ndjeshëm. Të gjitha shërbimet ju kanë dhënë pacientit në fjalë ne bazë të librit të protokollit por edhe në bazë te kamerave të sigurisë.

Alban Salihu, tha se ne bazë te drejtorit të shëndetësisë po konstatohet se drejtori nuk është suspenduar nga ana jonë. Na nuk kemi kërkuar suspendimin e mjekut. Sa mjek kanë qenë në nderim atë ditë qe ka ndodhur rasti.

Daut Azemi kryesues i kuvendit, tha kur diskutoni përfundoni fjalimin dhe mos ju drejtoni akujt mos bëni debat interaktiv, pasi qe se secilit qe do kërkon fjalë do te ja kaloj fjalën.

Gazmedn Qerkini tha, se asamblesiti i LVV-së Albani, në postimin e parë të tij në facebook ka deklaruar se: “E rëndë: Posa u njoftuam se në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Lipjan, ka vdekur një person nga sulmi në zemër, i cili kishte pritur mbi 1 orë pa iu ofruar ndihmë e pa u trajtuar, sepse nuk ishte asnjë mjek, kurse pajisjet nuk punonin as në ambulante e as në emergjencë ku jemi duke mbledhur informacione për rastin dhe do të ju njoftojmë për

detajet. Ndërsa shkrimi i dytë: veprimi i komunës është më shumë i kjo nga përgjegjësia se sa adresim, nuk mund t'i hidhet përgjegjësia një mjeku, kjo është çështje menaxhimi. Ftoj prokurorinë që të merret me këtë rast. ndërsa shkrimi i tretë thuhet: Dje EKG në urgjencë dhe QKMF nuk ka funksionuar. Doktorin Faruk Gashi e ka thënë të vërtetën, andaj suspendimi i tij është i padrejtë. Ktheje doktorin në punë e merrni masa ndaj personave përgjegjës”

Mjeku ka ekzistuar, EKG-ja ju ka bërë dhe nuk është dashtë të bëhet kaq e madhe kjo punë. Ne shëndetësi e dimë që ka nevojë për investime po nuk është edhe zi siç po e bëni ju. Shkoni në disa QMF në fshatrat e Lipjanit dhe i shihni që janë bërë do investime

Alban Salihu, tha e kemi një deklaratë për fund të cilën e lexoi në vazhdim:

DEKLARATË

Është përgjegjësi e Komunës si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale që të planifikojë, zhvillojë dhe sigurojë shërbime adekuate shëndetësore për qytetarët. Është e dukshme që gjendja në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan dhe në AMF-të është e rëndë.

Mungesa e vizionit, mos konsiderimi si prioritet për vite me radhë e menaxhimi i keq, ka bërë që qytetarët e Lipjanit të privohen nga shërbimet cilësore elementare shëndetësore. Kjo gjendje kulmoi këto ditë me ngjarjen e dhimbshme të vdekjes së një qytetari, të cilit nuk ju ofrua shërbimi mjekësor si pasojë e mosfunksionimit të pajisjeve vitale për raste të tilla. Ky nuk është rasti i vetëm kur qytetarët kthehen mbrapshtë me arsyetime të tilla të mosfunksionimit të pajisjeve e mungesa e shërbimeve të nevojshme.

Nisur nga kjo e sensibilizimi publik, si dhe shqetësimet e vazhdueshme të qytetarëve për cilësinë e ulët të shërbimeve shëndetësore, por edhe përgjegjësinë e Komunës për t'i garantuar këto shërbime;

Mbështetur në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenet 10 dhe 18 të Ligjit për Shëndetësi, Kuvendi Komunal i Komunës së Lipjanit miraton këtë deklaratë:

1. Drejtoria e Shëndetësisë, brenda 30 ditëve, duhet të sjellë një raport të detajuar të gjendjes së QKMF-së dhe AMF-ve të Lipjanit, përfshirë regjistrin e pajisjeve mjekësore në dispozicion dhe gjendjen e tyre, bashkë me detajet e vjetërsisë së tyre;

2. Drejtoria e Shëndetësisë, duhet të sjellë raport të detajuar se sa raste kanë kërkuar shërbimin e EKG-së në QKMF nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2021;
3. Të shkarkohet menjëherë Drejtori i QKMF-së;
4. Në buxhetin e vitit të ardhshëm të rritet buxheti komunal për shëndetësi për së paku 25%.

Lumturiqe Btyqi-Hasani, doktori duhet të kthehet në punë, se ju keni deklaruar se për shkak të neglizhimit të punës është suspenduar doktori, por ju vet po deklaroni se doktori nuk e ka neglizhuar punën. Ndoshta sjellja e doktorit ska qenë në nivel po i ka trajtuar 200 njerëz brenda ditës .

Le të anulohet vendimi për suspendim dhe të kthehet doktori në punë., kjo kërkoj qe të hyj në deklaratë.

Daut Azemi kryesues i Kuvendit tha se deklaratën është dashtë me ne e shpërnda pak më herët, pasi qe nuk e kemi.

Shkelzen Hajdini, tha doktori nuk është shkarkuar nga puna ,por është suspenduar përkohësisht, ai shkon tash ne komision dhe komisioni vendos a kam pas te drejt apo nuk kam pas të drejtë

Fitim Mëziu, mjeku ne video është me mantel dhe është në vend të punës dhe nuk ka asnjë të keqe aty. Ne në kujdesin primar shëndetësor e kemi të drejtën edhe civilë me kanë ne vend të punës.

Ganimete Qeriqi, çfar shkelje ka bo doktori ne video qe është shkarkuar, aty i thotë pacienti boma nja EKG, mjeku i thotë nuk bon EKG-ja, por po ta mati tensionin dhe aty nuk ka asnjë shkelje nga ana e mjekut.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se tani po e hodhi në votim deklaratën e lexuar me parë dhe pas votimin u konstatua se ,pas votimin me 14 vota për dhe 16 vota kundër nuk kaloi kjo deklaratë

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16,⁵⁰

Ekstraktin e hartoi

Zyrtari ligjor

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi